

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BATIMARINE OWNER SHIP “ SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 06.04.2021, une i nenshkruari:

1. **FLORIAN BIBA**, i datëlindjes 06.05.1996, shtetas zvicerian, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi E2562475

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

“BATIMARINE OWNER SHIP “ SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Lagjja 13, Shkemb i Kavajes, Plazh, Zona Kadastrale 8518, Godine me nr. Pasurie 58/569, Durrës

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Transport detar kombëtar dhe ndërkombëtar i mallrave dhe produkteve të ndryshme, për vetë dhe për të tretë .
- Agjenci detare, speditore.
- Agjenci transporti udhëtarësh e mallrash.
- Blerje-Shitje anijesh. Dhenie dhe marrje mjete me qira, asete, pasuri të paluajtshme etj.
- Tregtim i mallrave të ndryshëm industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, dhe gjithçka tjetër që është e lejueshme për këtë lloj shoqërie.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejten e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj(sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901,dt.14.04-08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njqindmije)** Lekë, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

FLORIAN BIBA, është zotërues i 1 kuote, me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 100.000 leke.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **FLORIAN BIBA**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

FLORIAN BIBA

